VENDIM
Nr. 333, datë 25.4.2013

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË PJESE TRUALLI TË PRONËS "QENDRA E FORMIMIT POLICOR" SAUK, TIRANË, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "e" të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të një pjese trualli të pronës "Qendra e Formimit Policor" Sauk, Tiranë, me sipërfaqe prej 2300 (dy mijë e treqind) m^2, pjesë e pasurisë 69/1, e ndodhur në zonën kadastrale 3266, nga Ministria e Brendshme të Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas planvendosjes (pjesa e ngjyrosur), që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sigurimin e mjediseve shtesë për veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë.
2. Sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha